

PLAN ZBATIMI PËR RISHIKIMIN DHE PËRMBUSHJEN E KONTRIBUTIT KOMBËTAR TË PIKËSYNUAR (KKP) TË SHQIPËRISË

Konteksti

Shqipëria ka bazë ligjore për ndryshimet klimatike; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është Pika Qendrore Kombëtare e UNFCCC-së, përgjegjëse për programin kombëtar të ndryshimeve klimatike. Një Grup Pune Ndërmnistror është instrumenti i koordinimit ndërsektorial të programit. Nën kuadrin e transparencës së UNFCCC-së dhe Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria duhet të raportojë një herë në dy vjet mbi ecurinë e KKP-së duke filluar nga dhjetori 2024. Çdo pesë vjet bëhet një Inventar Botëror i arritjeve të Marrëveshjes së Parisit, i radhës i planifikuar për 2028, ndaj qeveria duhet të jetë e përgatitur të tregojë përpjekje dhe përparim.

Koordinimi ndërsektorial për zbatimin e KKP-së ka qenë joefektiv që prej komunikimit të tij pranë UNFCCC-së. Shkaqet janë një KKP e pa operacionalizuar, me vlerësime të ndryshme të nevojave financiare, pa strategji financimi, dhe aftësi të pamjaftueshme të qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile për koordinim.

Integrimi gjinor në proceset e zbutjes dhe përshtatjes klimatike mbetet i pamjaftueshëm; pavarësisht udhëzuesve për institucionet qendrore, ndërgjegjësimi, aftësitë teknike dhe vullenti politik janë të ulëta, dhe treguesit gjinorë kombëtarë, shumë të kufizuar. Studimet mbi ndikimin klimatik me bazë gjinore kanë munguar ose kanë qenë jo të plota dhe statistikisht jo të rëndësishme; ato ekzistuese nuk janë përdorur për planifikimin strategjik, i cili vazhdon të bazohet vetëm në teori.

Qëllimi i projektit

Projekti synon të përmirësojë kuadrin strategjik kombëtar për zbatimin e KKP-së dhe të ndërtojë aftësitë e qeverisë, sektorit privat dhe aktorëve të shoqërisë civile për një proces efektiv kombëtar ndërsektorial për zbatimin e KKP-së.

Qëllimi i projektit është të ndihmojë në arritjen e KKP-së së Shqipërisë përmes mobilizimit dhe përshkallëzimit të financimit për klimën.

Lidhur me barazinë gjinore, projekti do të kryejë një analizë të situatës së treguesve gjinorë të integruar në komponentët e zbatimit të KKP-së: qeverisja, zbutja dhe përshtatja, do të identifikojë mangësitë dhe mungesat, dhe do të planifikojë aktivitetet për zbatimin e KKP-së me bazë gjinore.

Produktet dhe aktivitetet

- **Plani i Zbatimit të KKP-së së Shqipërisë:** Plan gjithëpërfshirës me një strategji financiare për koordinim efektiv ndërsektorial.
- **KKP e përditësuar për sektorin e pyjeve dhe përdorimeve të tjera të tokës:** Rivlerësim i potencialit të reduktimit të shkarkimeve, potencialit të përthithjes së karbonit dhe potencialit të politikave dhe masave të menaxhimit të tokës pyjore, bazuar në përparimet më të fundit në kuadrin ligjor, kuadrin strategjik, teknologjinë dhe të dhënat e sektorit
- **Plani i veprimit të politikave financiare dhe jo-financiare:** Strategji për përfshirjen e sektorit privat në financimin për klimën me qëllim mobilizimin e investimeve private
- **Udhëzues mbi përditësimin e rregullt të planit të zbatimit të KKP-së:** Kuadër operacional për monitorim dhe përditësime të rregullta të planit të zbatimit

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

Fondi për Klimën e Gjelbër (GCF)

PARTNERËT

• Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

KOHËZGJATJA:

01/06/2025 - 30/11/2027

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja
11, Ap. 56 Tiranë, Shqipëri
Tel.: +355694333808
E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU-t

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

